

VENDIM
Nr.845, datë 27.10.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE PËR SHPENZIMET KORENTE,
BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA PËR MINISTRINË E DREJTËSISË, NË
BUXHETIN E VITIT 2010**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve buxhetore, zëri “Shpenzime korente”, brenda programeve të miratuara për Ministrinë e Drejtësisë, në buxhetin e vitit 2010, si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit t’i shtohet fondi, në masën 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

b) Programit të sistemit të burgjeve t’i shtohet fondi, në masën 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekë.

c) Programit të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor t’i pakësohet fondi, në masën 9 000 000 (nëntë milionë) lekë.

d) Programit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave t’i pakësohet fondi, në masën 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha